


# ÇKA ËSHTË AVOKATI I POPULLIT?



Република Северна Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ  
Republika e Maqedonisë së Veriut  
AVOKATI I POPULLIT  
Republic of North Macedonia  
O M B U D S M A N



Avokati i popullit është organ i pavarur i përcaktuar me Kushtetutë. Në vitin 2017 dhe 2019 Avokati i popullit filloi me zbatimin e kompetencave të reja, me çka zgjeroi mundësitë për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve. Përkaj kompetencave të tij ekzistuese, Avokati i popullit filloi të veprojë si mik i gjykatës, mekanizëm i kontrollit civil, të kryejë monitorimin e zbatimit të Konventës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe të veprojë si raportues nacional për trafikimin e qenieve njerëzore dhe migracionin ilegal.



## ÇKA MUND TË BËJË AVOKATI I POPULLIT?

Kur konstatohet shkelje e së drejtës së qytetarit, Avokati i popullit jep rekomandime, mendime, sugjerime, pranë institucioneve shtetërore për eliminimin e shkeljeve. Organet duhet ti respektojnë intervenimet e tij në të kundërtën, Avokati i popullit mund të njoftojë organin më të lartë ( drejtorin/ zyrtarin që administron organin, Qeverinë), me raport të veçantë mund të informojë Kuvendin, apo ta ekspozojë në kritikë publike secilin që ka bërë shkelje, dhe nuk ka vepruar sipas rekomandimeve të Avokatit të popullit.



## ÇKA NUK MUND TË BËJË AVOKATI I POPULLIT?

Avokati i popullit nuk vendosë mbi bazën e të drejtave të qytetarëve, nuk mund të ndryshojë vendimet e miratuara administrative-gjyqësore, ai nuk ka të drejtë të ndëshkojë e as të veprojë si organ gjyqësor.



## ÇKA PASI TË KENI PARASHTRUAR PARASHTRESË?

Parashtresa shqyrtohet dhe nëse ka arsye për veprim, Avokati i popullit hap procedurë, për rrjedhën e së cilës e njofton parashtruesin. Nëse parashtresa është e pa bazë, nuk ngritet procedurë, por qytetari merr këshilla juridike.



## SI T'I DREJTOHENI AVOKATIT TË POPULLIT

Çdoherë kur konsideroni se ju cenohet e drejta apo keni nevojë për këshillë juridike mundeni personalisht të vini në zyrën e Avokatit të Popullit në Shkup, si dhe në zyrat rajonale në: Tetovë, Kumanovë, Kërçovë, Manastir, Strumicë dhe Shtip. Mund të drejtoheni përmes telefonit, postës, telefaksit ose përmes postës elektronike.



### KONTAKT

AVOKATI I POPULLIT  
Rr "Makedonija" num: 19, Shkup  
+389 2 3129 335  
contact@ombudsman.mk

**DREJTOHUNI  
TEK AVOKATI  
I POPULLIT**

